



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:245095

Datë: 03.01.2025

Numri i dokumentit: 06679086

KE.nr.454/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit “Arda Rei” SH.P.K., me numër unik identifikues 810317562, me seli në rr. Bill Klinton, Zona Industriale, 10000, Prishtinë, Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve RPHS Law, kundër të paditurit Qeveria e Kosovës, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Fitore Byqmeti nga Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti, pasurim pa bazë, vlera e kontestit 88,083.53€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 17.12.2024, në prezencë të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datën 03.01.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Arda Rei” SH.P.K., kundër të paditurit Qeveria e Kosovës, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, me të cilën ka kërkuar që në emër të pasurimit pa bazë si rezultat i ndryshimit të TVSH-së, t’ia kompensoj paditësit shumën prej 88,083.53€ me kamatë ligjore nga data e paraqitjes së kërkesës tek i padituri 22.09.2012 e deri në përmbushjen përfundimtare.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

1. Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve

Paditësi “Arda Rei” SH.P.K., pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, më 31.01.2019, ka paraqitur padi ndaj të paditurit Qeveria e Kosovës, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, me kërkesën që në emër të pasurimit të pabazë si rezultat i ndryshimit të TVSH, paditësit ti paguaj shumën prej 88,083.53€ me kamatë ligjore nga data 22.09.2012 si datë e paraqitjes së kërkesës tek i padituri për kthimin e mjeteve.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit I.EK.nr.45/2019 të datës 05.01.2019 kishte refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, me të cilën ka kërkuar që e paditura Qeveria e Kosovës, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, në emër të pasurimit pa bazë si rezultat i ndryshimit të TVSH-së, t'ia kompensoj paditësit shumën prej 88,083.53€ me kamatë ligjore nga data e paraqitjes së kërkesës tek i padituri 22.09.2012 e deri në përmbushjen përfundimtare.

Kundër këtij Aktgjykimi, paditësi kishte ushtruar ankesë lidhur me të cilën kishte vendosur Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, e cila përmes Aktvendimit K.Dh.Sh.II.nr. 801/22 të datës 18.05.2023 kishte aprovuar ankesën e të paditurit dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim, me konstatimin se shkalla e parë gabimisht ka zbatuar dispozitat e së drejtës materiale me rekomandimin që të vërtetohet kur ka arritur për përmbushje detyrimi respektivisht kur ka filluar të rrjedhë afati i parashkrimit.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore në rigjykim, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Ka shtuar se lidhur me kërkesën për pasurim të pabazë si rezultat i diferencimit të kalkulimit të TVSH-së, ku konform kontratës publike respektivisht pika 13.3 e kushteve të përgjithshme, e paditura ka pasur për obligim të harmonizoj çmimin kontraktues në rast të ngritjes tatimore brenda 28 ditëve, në rastin konkret me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 03L.114 për TVSH, norma e TVSH-së është ngritur për 1%, gjegjësisht nga 15% në 16%, me një implikim financiar prej 69,432.00 €, për të cilin e paditura ka dështuar ta bëjë harmonizimin, përkundër kërkesës së vazhdueshme të paraqitur nga paditësi pranë të paditurës. Gjithashtu ka theksuar se Dhoma e Shkallës së Dytë e kësaj Gjykate në mënyrë të drejtë ka vërtetuar se kërkesa e paditësit nuk është e parashkruar pasi që në kuptim të nenit 34 të Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet mbi Marrëdhëniet Detyrimore, fletorja zyrtare RFJ Nr.31/93 që ka hyrë në fuqi me datën 25.06.1993, me të cilën është ndryshuar nenin 371 i LMD-së, ashtu që afati i parashkrimit nga 5 vite është ndryshuar në 10 vite, andaj gjykatës i ka propozuar që ta aplikoj këtë afat të parashkrimit si ligj i zbatueshëm edhe në kontekst të rregullores së UNMIK-ut 1999/24, nenin 1.2. ku thuhet se të gjitha ligjet që janë nxjerr pas datës 22 mars 1989 e të cilat nuk kanë karakter diskriminues vazhdojnë të zbatohen në Kosovë.

Në fjalën përfundimtare ka theksuar se nga provat e administruara evidentohet që e paditura në rastin konkret është pasuruar pa bazë juridike me rastin e ndryshimit të normës së TVSH-së për të cilën paditësit nuk ia kishte njohur diferencën ndonëse, e kishte një obligim të tillë. Më konkretisht nga provat e administruara evidentohet që palët kanë pasur një raport kontraktual të

evidentuar me nr.të prot. 2601 për aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rreth rrotullimit në udhëkryqin e rrugëve magjistrale M9 dhe M2 në Prishtinë” Sipas kësaj kontrate çmimi kontraktues ka qenë në vlerën prej 11.750.446.99 Euro, më tej në pikën 13 të Aneksit e paditura është obliguar që ta harmonizoj këtë çmim kontraktues brenda 28 ditëve nëse ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore, në rastin konkret ka pasur ngritje të TVSH-së, me një dallim prej 1% pasi që ka hyrë në fuqi Ligji 031-114 për TVSH i datës 31.12.2008, ku norma e TVSH-së nga 15% ishte bërë 16%. Mbi këtë bazë vlen të theksohet se paditësi i është drejtuar të paditurës me dy kërkesa të njëpasnjëshme respektivisht një herë me datën 26.09.2012 dhe 10.10.2012, mirëpo e paditura ka refuzuar ta pranojë këtë diferencë me ç ‘rast paditësi është detyruar të iniciojë këtë padi. Lidhur me pretendimet e të paditurës se kërkesa për pasurim të pa bazë është parashkruar, ka vlerësuar se e njëjta është në tërësi e pabazuar, për këtë vlen të evidentohet edhe gjetjet e vendimit të Gjykatës së Apelit ku e ka rrëzuar argumentin që kërkesa është e parashkruar për tre vite sipas nenit 374 të LMD-së. Tutje, ka shtuar se në rastin konkret aplikohet neni 34 i Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve RFJ 31/93 i datës 18.06.1993, ku parashkrimi është caktuar me një afat 10 vjeçare, për më tepër ky ligj aplikohet për shkak se nuk ka karakter diskriminues konform rregullores së UNMIK-ut 1999/24, ndërsa ka konsideruar se pas administrimit të provave qartazi është vërtetuar se e paditura është pasuruar pa bazë juridike në vlerën prej 88,88.53Euro në emër të borxhit kryesor si dhe më pas kamatat e aplikueshme të cilat janë evidentuar në ekspertizën financiare të pranuar në këtë gjykatë me datën 01.10.2024. Përfundimisht paditësi ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit ashtu që ta detyroj të paditurën që në emër të fitimit të pa bazë respektivisht në emër të ndryshimit të TVSH-së, të bëjë kompensimin në vlerë prej 88.88,53 Euro, si borxh kryesor si dhe kamatën e aplikueshme së paku nga data e paraqitjes së kërkesës nga paditësi tek e paditura e datës 22.09.2012, deri në pagesën definitive, ndërsa në alternativë ka kërkuar nga gjykata që kamatën ta aplikoj nga paraqitja e padisë e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës, i ka kërkuar në shumën e përgjithshme prej 2.118 Euro, për pesë përfaqësime gjyqësore shumën në vlerë prej 270.40 Euro, për ekspertizën financiare shumën prej 350 dhe për dy parashtresa respektivisht për padi dhe ankesë shumën prej 208 Euro për secilën.

I padituri, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datën 26.01.2020, ka paraqitur përgjigje në padi përmes së cilës ka kundërshtuar padinë e paditësit me arsyetimin se kërkesëpadia e paditësit e është parashkruar bazuar në nenin 371 të LMD-së, (i aplikueshëm), më saktësisht kontrata për ndërtimin e rreth rrotullimit në udhëkryqin e rrugës magjistrale M9 dhe M2, është lidhur me datë

28.10.2008, pranimi teknik dhe llogaria përfundimtare, është pranuar pa asnjë vërejtje nga A.H., Drejtor i Kompanisë “Arda Rei” si dhe nga A. Sh. Udhëheqës i Punimeve nga “Arda Rei” me datën 03.10.2012, ndërsa padia është dorëzuar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 31.01.2019. Gjykatës i ka propozuar që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore edhe në fjalën përfundimtare përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kundërshtimeve të paraqitura si dhe ka shtuar se edhe në këtë fazë të procedurës gjykata duhet të refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit “Arda Rei” SH.P.K., me arsyetimin se kërkesëpadia e paditësit e cila tashmë është objekt shqyrtimi është parashkruar bazuar në nenin 371 të LMD-së, më saktësisht kontrata për ndërtimin e rreth rrotullimit në udhëkryqin e rrugës magjistrale M9 dhe M2 është lidhur me datë 28.10.2008, pranimi teknik dhe llogaria përfundimtare është bërë me datë 03.10.2012. Ndërsa padia është dorëzuar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike me datë 31.01.2019. Po Ashtu ka shtuar se i kundërshton edhe pretendimet e të autorizuarit të paditësit kinse afati i përgjithshëm i parashkrimit është 10 vjeçar sipas ndryshimeve të bëra në LMD- në RSFJ me nr. 31/93 me arsyetimin se dispozitat ligjore të miratuara dhe të ndryshuara gjatë vitit 93 dhe 2003 nuk janë të aplikueshme në territorin e Republikës së Kosovës, andaj duke pasur parasysh sqarimet e bëra më lartë gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadinë e paditësit “Arda Rei” për shkak të parashkrimit të padisë e cila është objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor.

2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore dhe në bazë të propozimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata në rigjykim gjatë procedurës së provave bëri administrimin e këtyre provave: Pro faturë e datës 28.10.2008; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 178 e datës 22.04.2009; Fatura e datës 16.04.2009; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 263 e datës 25.05.2009; Fatura e datës 22.05.2009; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 384 e datës 30.06.2009; Fatura e datës 01.07.2009; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 474 e datës 03.08.2009; Fatura e datës 03.08.2009; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 622 e datës 14.09.2009; Fatura e datës 11.09.2009; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 955 e datës 08.12.2009; Fatura e datës 07.12.2009; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 1075 e datës 18.12.2009; Fatura e datës 24.03.2010; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës e datës 24.03.2010; Fatura

e datës 02.08.2010; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 479 e datës 03.08.2010; Fatura e datës 02.09.2010; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 549 e datës 01.09.2010; Fatura e datës 01.10.2010; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 652 e datës 04.10.2010; Fatura e datës 07.12.2010; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 898 e datës 14.12.2010; Fatura e datës 18.07.2011; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 367 e datës 18.07.2011; Fatura e datës 10.08.2011; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 421 e datës 12.08.2011; Fatura e datës 10.11.2011; Fatura e datës 20.01.2012; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 541 e datës 23.08.2012; Fatura e datës 22.08.2012; Kontratë nr.2601 e datës 28.10.2008, Kushtet e Përgjithshme të Kontratës dhe Aneksi II – Speifikimet teknike të detyrueshme; Aneks kontratë për punime shtesë nr.3288 e datës 25.08.2010; Aprovimi i raportit për punë shtesë i datës 20.08.2010; Raport i vlerësimit të kërkesës për punë shtesë - gusht 2010.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka konstatuar këtë gjendje faktike.

Gjykata konstatoi se nuk ishte kontestuese që mes palëve ndërgjyqëse ishte lidhur Kontratë nr.2601 e datës 28.10.2008 për ndërtimin e rreth rrotullimit në udhëkryqin e rrugës magjistrale M9 dhe M2 në Prishtinë ku çmimi kontraktues ishte në vlerë prej 11,750,446.99€.

Në mes palëve nuk ishte as kontestuese se pas nxjerrjes së raportit të vlerësimit të kërkesës për punë shtesë - gusht 2010 palët me datën 20.08.2010 kishin bërë aprovimin e këtij raporti ku si rrjedhojë me datë 25.08.2010 palët ndërgjyqëse kanë lidhur edhe Aneks kontratën për punime shtesë nr.3288, ndërsa me datën 03.10.2012 paditësi kishte bërë pranimin teknik dhe llogaritjen përfundimtare të punimeve shtesë të realizuar sipas Ankes Kontratës.

Kontestuese mes palëve ishte nëse e paditura ka qenë e obliguar që ta harmonizoj çmimin kontraktues brenda 28 ditëve në rast të ngritje të tatimeve me një dallim prej 1% pas hyrjes në fuqi Ligji 03/L-114 për TVSH i datës 31.12.2008, ku norma e TVSH-së nga 15% ishte rritur në 16% dhe si rrjedhojë paditësit i ishte shkaktuar dëm financiarë në vlerë prej 88,083.53€ dhe nëse kërkesëpadia e paditësit ishte parashtruar.

Me qëllim të vërtetimit të lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata në rigjykim gjatë seancës së datës 23.07.2024, ka aprovuar propozimin e paditësit për nxjerrjen e ekspertizës financiare, me të cilën

është kërkuar që të bëjë vlerësimin e diferencës së vlerës për shkak të ndryshimit të lartësisë së TVSH-së, nga 15% në 16%, sipas Ligjit Nr.03/L – 146 për TVSH-së i cili ka hyrë në fuqi më 20.02.2010 si dhe të bëjë përcaktimin e kohës së arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, duke bërë ndarjen e diferencës sipas secilës faturë të dorëzuar nga paditësi. Eksperti financiar Avni Berisha në ekspertizën e dorëzuar në gjykatë me datë 01.10.2024, ka konstatuar se avansi sipas kontratës nr. 181/2008 i pranuar nga paditësi në shumë prej 2,350,089.40€ përfshinë TVSH-në në lartësi prej 15% (20% e totalit të përgjithshëm të vlerës së Kontratës) është para ndryshimeve ligjore të lartësisë së TVSH-së nga 15% në 16% por efektin e zbritjeve e ka pasur gjatë pagesa të situacioneve, pra avansi është pranuar me TVSH 15%, por është zbatuar në pagesa me efekt të TVSH-së 16%. Po ashtu ka përcaktuar se vlera totale e kontratës ka qenë në 11,750,446.99, ndërsa ndryshimi mes TVSH 15% edhe 16% është 88,084.31€.

Gjykata kërkesën e paditësit për plotësimin e ekspertizës në atë mënyrë që llogaritja e kamatës të bëhet sipas mendimit juridik për kamatën të gjykatës supreme të datës 01.12.2020 që për detyrimet e lindura pas datës 19.12.2012 të aplikohet kamata në lartësi prej ligjore prej 8% e ka refuzuar me arsyetimin se kërkesa për të cilën është propozuar plotësimi nuk ka qenë kërkesë e paditësit në padi që të bëhet llogaritja për secilën kërkesë veç e veç, por kamata është kërkuar nga data e 22.09.2012.

Po ashtu Gjykata si provat i ka vlerësuar edhe provat si: Pro faturë e datës 28.10.2008; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 178 e datës 22.04.2009; Fatura e datës 16.04.2009; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 263 e datës 25.05.2009; Fatura e datës 22.05.2009; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 384 e datës 30.06.2009; Fatura e datës 01.07.2009; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 474 e datës 03.08.2009; Fatura e datës 03.08.2009; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 622 e datës 14.09.2009; Fatura e datës 11.09.2009; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 955 e datës 08.12.2009; Fatura e datës 07.12.2009; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 1075 e datës 18.12.2009; Fatura e datës 24.03.2010; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës e datës 24.03.2010; Fatura e datës 02.08.2010; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 479 e datës 03.08.2010; Fatura e datës 02.09.2010; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 549 e datës 01.09.2010; Fatura e datës 01.10.2010; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 652 e datës 04.10.2010; Fatura e datës 07.12.2010; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 898 e datës 14.12.2010;

Fatura e datës 18.07.2011; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 367 e datës 18.07.2011; Fatura e datës 10.08.2011; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 421 e datës 12.08.2011; Fatura e datës 10.11.2011; Fatura e datës 20.01.2012; Zhvillimi i kontratës, pozicionet dhe certifikata e pagesës nr. 541 e datës 23.08.2012; Fatura e datës 22.08.2012, por ka vlerësuar se të njëjtat janë vlerësuar në aspektin financiar nga eksperti financiar ndërsa gjykata ka konsideruar se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje lidhur me vendosjen përfundimtare andaj gjykata nuk bëri vlerësimin e të njëjtat veç e veç.

3. Baza ligjore

Nga faktet e vërtetuara, Gjykata gjeti se në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78) i cili kanë qenë në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës për ndërtimin e rreth rrotullimit në udhëkryqin e rrugës magjistrale M9 dhe M2 në Prishtinë, kjo në bazë të të Rregullores së UNMIK nr. 1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë e datës 12.12.1999, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren e UNMIK nr. 2000/59, e datës 27.10.2000.

Neni 371 i LMD-së ka përcaktuar se: *“Kërkesat parashkruhen për pesë vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit”*.

Neni 1 i Rregullores së UNMIK nr. 1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë e datës 12.12.1999 ka përcaktuar se: *“1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshin: (a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe (b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989. Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to. 1.2. Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj.”*

4. Vlerësimet e gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pa bazuar, për faktin se nga provat e administruara është vërtetuar se padia e paditësit është parashkruar.

Sipas vlerësimit të gjykatës kërkesa e paditësit që në emër të pasurimit të pa bazë si rrjedhojë ngritjes së tatimeve, me një dallim prej 1% pas hyrjes në fuqi të Ligji 031-114 për TVSH i datës 31.12.2008, ku norma e TVSH-së nga 15% ishte bërë 16% është parashkruar për faktin se, pranimi teknik dhe llogaria përfundimtare për kontratën për ndërtimin është bërë me datë 03.10.2012, ndërsa padia e paditësit është dorëzuar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike me datë 31.01.2019 sipas nenit 371 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78).

Lidhur me zbatimin e Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet mbi marrëdhëniet detyrimore sipas Fletores Zyrtare RFJ nr. 31/93 të datës 18.06.1993 dhe i cili ka hyrë në fuqi me datë 25.06.1993 gjykata vlerëson se ky ligj nuk është i zbatueshëm në kuptim të Rregullores së UNMIK nr. 1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë e datës 12.12.1999, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren e UNMIK nr. 2000/59, e datës 27.10.2000, pasi që në nenin 1 par. 1.1 është përcaktuar se *“Ligji në fuqi në Kosovë përfshin: (a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe (b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.”* Ndërsa, par. 1.2 i nenit 1 ka përcaktuar se: *“Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj.”*

Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se me paragrafin 1.1 të nenit 1 të Rregullores së UNMIK nr. 1999/24 janë përcaktuar dy kategori të ligjeve që gjejnë zbatim në Kosovë dhe atë Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe Legjislacioni në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Përjashtimisht, par. 1.2 i nenit 1 të Rregullores së UNMIK nr. 1999/24 përcakton tri kritere të cilat duhet të plotësohen për zbatimin e ligjeve që kanë hyrë në fuqi pas datës 22 mars 1989 dhe atë vetëm nëse gjykata konstaton se: a) çështja ose situata nuk mund të mbulohet nga Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989; b) nuk është diskriminues dhe c) është në përputhje me konventat e përcaktuara në paragrafin 1.3 të nenit 1 të Rregullores.

Pra, sipas nenit 1, par. 1.2 të Rregullores së UNMIK përcaktohet se vetëm në rastet kur një gjykatë ose organ tjetër gjen se nuk ka rregullore të UNMIK apo dispozitë ligjore që ka qenë në fuqi para datës 22.03.1989 dhe që e rregullon një çështje të caktuar, atëherë, përjashtimisht, mund të aplikohen dispozitat ligjore që kanë hyrë në fuqi pas datës 22.03.1989. Mirëpo edhe në rastin e tillë, gjykata apo organi i tillë duhet të kujdeset që dispozita e tillë (e pas datës 22.03.1989) nuk është diskriminuese dhe është në përputhje me së paku tetë (8) instrumente ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në rastin konkret, gjykata konsideron se ekziston një dispozitë ligjore që ka qenë në fuqi para datës 22.03.1989 e cila rregullon institutin e parashkrimit.

Plotësimet dhe ndryshimet e bëra me Ligjin mbi ndryshimet dhe plotësimet mbi marrëdhëniet detyrimore sipas Fletores Zyrtare RFJ nr. 31/93 të datës 18.06.1993 janë rregulla ligjore të cilat kanë hyrë në fuqi pas datës 22 mars 1989, përkatësisht me datë 25.06.1993 dhe për zbatimin e këtyre dispozitave sipas nenit 1 par. 1.2 të Rregullores së UNMIK duhet të plotësohet kushti që e njëjta çështje ose situatë të mos ketë qenë e rregulluar me Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe me Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Lidhur me pasurimin pa bazë dhe afatin e përgjithshëm të parashkrimit, si legjislacion në fuqi në Kosovë deri me 22 mars 1989 ka qenë Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78) i cili në nenin 371 ka përcaktuar se: *“Kërkesat parashkruhen për pesë vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit”*.

Duke qenë se çështja e afatit të përgjithshëm të parashkrimit ka qenë e rregulluar me legjislacionin në fuqi në Kosovë (Ligji mbi Detyrimet, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78) deri me 22 mars 1989, gjykata vlerëson se nuk është plotësuar kriteri i parë i përcaktuar në nenin 1 par. 1.2 të Rregullores së UNMIK për zbatim të legjislacionit pas datës 22 mars 1989. Pra, përderisa ekziston një dispozitë ligjore e para datës 22.03.1989, nuk mund të aplikohet – përjashtimisht – dispozita ligjore që e rregullon të njëjtën çështje e që ka hyrë në fuqi pas datës 22.03.1989.

Pavarësisht se neni 34 i Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet mbi marrëdhëniet detyrimore (Fletorja Zyrtare nr. 31/93 e datës 18.06.1993) nuk është diskriminues dhe nuk është në kundërshtim me konventat e përcaktuara në paragrafin 1.3 të nenit 1 të Rregullores e njëjta dispozitë nuk gjenë zbatim për shkak të mos plotësimit të kriterit të parë përkatësisht se e njëjta

çështje apo situatë të mos ketë qenë e rregulluar me Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe me Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Andaj, gjykata vlerëson se në rastin konkret, lidhur me afatin e përgjithshëm të parashkrimit vlen nenin 371 i Ligjit mbi Detyrimet, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78 i cili përcakton afatin 5 vjeçar të parashkrimit të kërkesave në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit.

Mbi këto arsye, gjykata vlerëson se duhet aplikuar afati 5 vjeçar i parashkrimit, e jo afati 10 vjeçar i përcaktuar në Ligjin mbi ndryshimet dhe plotësimet mbi marrëdhëniet detyrimore sipas Fletores Zyrtare RFJ nr. 31/93 të datës 18.06.1993.

Lidhur me këtë, gjykata po ashtu morri parasysh edhe udhëzimet e Dhomës së Shkallës së Dytë lidhur me zbatimin e plotësimit të LMD të vitit 1993 në kuptim të rregullores së UNMIK, por gjykata vlerëson se neni 34 i plotësimit të LMD nr. 31/93 i datës 18.06.1993 nuk është i zbatueshëm për shkak të mos plotësimit të kriterit të parë përkatësisht se e njëjta çështje apo situatë të mos ketë qenë e rregulluar më parë siç përcaktohet me nenin 1, par. 1.2 të Rregullores së UNMIK.

Andaj, nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pa bazuar, kjo pasi që nga provat e administruara rezulton se njëjta është paraqitur me datë 31.01.2019, ndërsa kërkesa e paditësit ka arritur për pagesë me datë 03.10.2012 kur ishte bërë pranimi teknik dhe llogaritja përfundimtare të punimeve shtesë të realizuar sipas Ankes Kontratës, ashtu që nga koha e arritjes për pagesë e deri në ushtrimin e padisë kanë kaluar më shumë se 5 vite, përkatësisht rreth 6 vite e 4 muaj.

5. Shpenzimet e procedurës

Lidhur me shpenzimet gjyqësore si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi sipas nenit 452 par. 4 të LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, gjykata bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.454/23, datë 03.01.2025

Numri i lëndës: 2019:245095
Datë: 03.01.2025
Numri i dokumentit: 06679086

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të Aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.